**Republika e Kosovës**
Komuna e Drenasit (Gllogoc)
Kuvendi i Komunës
02 **Nr.**06/01-22885 **dt.** 15/06/ **2026**

Në bazë të nenit 44 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 34,37 të Statutit të Komunës së Drenasit, Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 Për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, neni 6, me kërkesën e bërë me shkrim nga Anëtaret e Kuvendit Komunal nr.02-070/01-22849 dt. 15/06/2026. Kryesuesi i Kuvendit me dt. 22.06.2026 (ditë e Hënë) duke filluar në ora 11:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Thërret
Mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës

Mbledhja do të ketë:

Rend dite:

1. Gjendja aktuale e furnizimit me ujë në Komunën e Drenasit.
2. Shkaqet e ndërprerjeve dhe mungesës se vazhdueshme të ujit.
3. Përgjegjësitë e operatorit furnizues KRU "Prishtina"
4. Masat urgjente për rikthim e furnizimit të rregullt me ujë.
5. Masat afatshkurtra dhe afatgjatë për zgjedhjen e problemit.
6. Mundësia e investimeve në infrastrukturë shtesë

Drenas, më 15.06.2026

Kryesuesi i Kuvendit të Drenasit
Burim Bujupi

043556699

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY

| PRANUAR | | 15/06/2026 | |
|---|---|---|---|
| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| 02-070/01-22849 | | | |

Drenas, 12/06/2026

**Drejtuar:** Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Drenasit

**Nga:** Asambleistët nënshkrues të Kuvendit Komunal të Drenasit

**Lënda:** Kërkesë për thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme lidhur me mungesën e furnizimit me ujë të pijshëm në Komunën e Drenasit

Të nderuar,

Ne, asambleistët nënshkrues të Kuvendit Komunal të Drenasit, në bazë të kompetencave tona ligjore dhe në përputhje me Rregulloren e Punës së Kuvendit Komunal, kërkojmë thirrjen e një mbledhjeje të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Drenasit.

Kjo kërkesë bëhet për shkak të situatës së rënduar dhe të vazhdueshme me mungesën e furnizimit me ujë të pijshëm në shumë vendbanime të komunës, ku qytetarët po përballen me ndërprerje të gjata dhe mungesë të plotë të këtij shërbimi jetik.

Gjendja aktuale është e papranueshme dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme, higjienën dhe shëndetin publik të qytetarëve, si dhe në funksionimin e institucioneve dhe bizneseve lokale.

**Në këtë mbledhje kërkojmë që të trajtohen këto çështje:**

1. Gjendja aktuale e furnizimit me ujë në Komunën e Drenasit
2. Shkaqet e ndërprerjeve dhe mungesës së vazhdueshme të ujit
3. Përgjegjësitë e operatorit furnizues KRU "Prishtina"
4. Masat urgjente për rikthimin e furnizimit të rregullt me ujë
5. Masat afatshkurtra dhe afatgjata për zgjidhjen e problemit
6. Mundësia e investimeve në infrastrukturë shtesë (rezervuarë dhe kapacitete ujore)

Duke marrë parasysh urgjencën e situatës dhe rëndësinë e shërbimit të furnizimit me ujë për qytetarët, kërkojmë që kjo mbledhje të thirret në afatin më të shkurtër të mundshëm, në përputhje me dispozitat ligjore dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit Komunal.

Me respekt,

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Nënshkrimi |
|---|---|---|
| 1. | Lulieta Elshani | L. Elshani |
| 2. | Tringa Bujupi | Bujupi |
| 3. | Driton Ajazi | [signature] |
| 4. | Mërgim Pirraku | [signature] |
| 5. | FATIME ELSHANI BERISHA | F. Berisha |
| 6. | Jahir Hajdari | [signature] |
| 7. | Muhamet Osmani | [signature] |
| 8. | Xhavit Drenori | [signature] |
| 9. | Artian Krasniqi | [signature] |
| 10. | ARGON SINANI | Sinani |
| 11. | Mahmud Salihu | M Salihu |